



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE,
SHËRBIMEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 801/Prot.
11

Patos më, 21 /103 /2023

RELACION

Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri-Projekti RESEAL

“Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor për gjashtë bashkitë e Qarkut Fier, përkatësisht për Bashkinë Fier, Lushnje, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër”

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, (UNDP/PNUD) në Shqipëri mbështet përpjekjet e vendit për përmirësimin e sistemit dhe kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë (MRF) - në nivel qendror dhe vendor. Qëllimi i përgjithshëm i projektit RESEAL është forcimi i sistemit të MRF-së në Shqipëri dhe mbështetja e përpjekjeve të vendit për t'u bërë një anëtar i plotë i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE). Gjithashtu, projekti është në përputhje me objektivin për nxitjen e zbatimit të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (KSZRF) dhe është hartuar bazuar në rekomandimet e raportit të vlerësimit të nevojave pas tërmetit të vitit 2019, në Shqipëri.

Në kuadër të projektit RESEAL, ka nisur zbatimin projekti **“Zhvillimi i vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor” për 6 (gjashtë) bashkitë e Qarkut Fier, përkatësisht për Bashkinë Fier, Lushnje, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër**, nën koordinimin dhe bashkërendimin e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC). Ky projekt do të zgjasë rreth 9 (nëntë) muaj, përgjatë periudhës Shtator 2022 – Qershor 2023.

Projekti do të mundësojë hartimin e dokumenteve me fokus **vlerësimin e risqeve të fatkeqësive** për secilën nga bashkitë e qarkut Fier, pjesë përbërëse e të cilave do të jenë edhe vlerësimi i kapaciteteve përbaluese të secilës Bashki.

Procesi dhe produktet fundore do të kryhet nga ekspertë të kualifikuar e të përzgjedhur me kujdes si dhe do të mbështetet në praktikën më të mirë vendore dhe ndërkombëtare. Dokumentet e hartuara në shkallë kombëtare si: vlerësimi i riskut, strategjia për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe plani kombëtar i emergjencave civile do të jenë referencë kryesore dhe do të shërbejnë si udhërrëfyes gjatë zhvillimit të këtij projekti. Gjithashtu, si dokumente të ngjashme të mëparshme do të mbahen parasysh edhe dokumentet e hartuara për bashkinë Lezhë në kuadrin e vlerësimit të riskut vendor dhe rritjes së kapaciteteve përbaluese.

Në kuadër të këtij projekti, për secilën bashki, do të përgatiten raportet dhe dokumentacioni përkatës për vlerësimin e riskut, që do të shërbejë për të përmbushur detyrimin ligjor që

rrjedh nga Ligji nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sa i takon kuadrit për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në shkallë vendore.

Ky projekt, pasi të kalojë të gjitha fazat e hartimit, këshillimit me bashkinë, me AKMC-në, me UNDP dhe me aktorë të tjerë vendor dhe qendror, mund të shërbejë në të ardhmen edhe si referencë për hartimin e dokumenteve të njëjësive të tjera vendore të vendit. Në linjë të përgjithshme, projekti ka në fokus vlerësimin e kapaciteteve përbaluese dhe vlerësimin e riskut për secilën bashki për gjashtë rreziqe kryesore: tërmete, përmblytje, zjarri, rrëshqitjet, pandemia dhe rreziku teknologjik. Më konkretisht, projekti përfshin:

- Kryerjen e vlerësimit të kapaciteteve njerëzore të secilës bashki për të përballuar risqet e ndryshme të fatkeqësive;
- Hartimin e dokumentit të vlerësimit të riskut për çdo bashki, në trajtë të përmbledhur dhe të zhvilluar për secilin risk;
- Mbështetje profesionale në ngritjen dhe funksionimin e komisioneve të Mbrojtjes Civile në nivel bashkie;
- Trajnim të komisioneve të Mbrojtjes Civile në të 6 bashkitë e qarkut Fier;
- Trajnimin dhe përgatitjen e një ekipi trajnerësh të cilët do të ndajnë njohuritë e tyre me stafin vendor të bashkive, në të ardhmen.

Për qëllimin e këtij projekti, IDRA Research & Consulting, UTS-01 dhe ekspertët përkatës do të bashkërendojnë veprimtarinë me AKMC, projektin RESEAL të UNDP dhe institucione të tjera në nivel qendror si në drejtim të përdorimit të qasjeve të njësuara në hartimin e dokumenteve ashtu edhe në përditësimin e të dhënave me natyrë kombëtare dhe në përfshirjen e udhëzimeve dhe sugjerimeve të përfutuara gjatë procesit.

Ekipi i projektit do të bashkëpunojë ngushtë me përfaqësuesit e bashkive për të përditësuar të dhënat e nevojshme dhe për të ndërvepruar për të rritur kapacitetet njohëse me qëllim që bashkitë në të ardhmen të rrisin kontributin vendor si në hartimin e procedurave të nevojshme ashtu dhe në rritjen e kapacitetit për të zvogëluar riskun dhe për të përballuar me efikasitet të rritur ngjarjet e mundshme në të ardhmen.

Në përfundim të projektit, arritjet e pritshme mund të përmbledhen si vijon:

- Bashkitë dhe ekipet përkatëse të mbrojtjes civile të pajisura me kornizë të konsoliduar dhe njohuri të nevojshme për të kontribuar në zvogëlimin e risqeve të fatkeqësive dhe me kapacitete të përmirësuara për tu përballuar fatkeqësitë e mundshme në të ardhmen. Rezultate priten edhe në drejtim të rritjes së aftësisë vendore për tu mëkëmbur përmes përdorimit të një sistemi frytdhënës dhe të integruar të mbrojtjes civile;
- Sisteme GIS të ngritura dhe funksionale në bashki me të dhëna të integruara të analizës dhe përfundimeve të projektit lidhur me vlerësimin e riskut dhe kapaciteteve përbaluese;
- Struktura të komisioneve të Mbrojtjes Civile të ngritura, funksionale dhe të afta për të interpretuar dhe përdorur me efikasitet gjetjet e Projektit në drejtim të zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe të rritjes së aftësisë përbaluese.

IDRA Research & Consulting dhe UTS-01, në bashkëpunim me njëra tjetrën dhe përmes ekipit teknik të përbërë nga profesionistë me ekspertizë dhe përvojë të spikatur në fushat që mbulon

projekti do të hartojë me përkushtim dhe cilësi dokumentet e nevojshme dhe do të ofrojë të gjithë ndihmën e duhur për vënin në zbatim të gjetjeve të projektit për secilën bashki të qarkut Fier.

Konceptoi:

Arben Shpërdheja

Anisa Kripa

